



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor –
ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i
Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

Projekti

UJRA TË MBROJTURA PËR KOMUNITETE TË SHËNDETSHME

**Monitorimi dhe Vlerësimi i gjendjes për
Bashkinë Elbasan**

Nëntor, 2019



**BASHKIA
ELBASAN**



Përgatitur sipas kontratës me UNDP
për Projektin Numër: 00101336 dhe 00095613

Kontakt:

Ndriçim Çela
Koordinator Projekti
Shoqata "AlbNatyra"



+355 68 357 6089
racfp.org@gmail.com

SHËNIM:

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e autorit dhe të Shoqatës AlbNatyra, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

UJRA TË MBROJTURA PËR KOMUNITETE TË SHËNDETSHME

Raporti i Monitorimit dhe Vlerësimit
Bashkia Elbasan
(Korrik – Nëntor 2019)

Nëntor, 2019

Përgatiti:

Migena Kukli
Ekspert Mjedisi
(MSc Ing.Mjedisi, EMPH)

migenakukli@yahoo.com

PËRMBAJTJA

1.0 HYRJE	7
1.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	7
1.2 BASHKIA ELBASAN	8
2.0 REZULTATET E MONITORIMIT NË TERREN	12
3.0 VLERËSIMI I CILËSISË SË UJIT TË LUMIT	19
3.1 RËNDËSIA E LUMIT	19
3.2 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PASURIVE UJORE SIPËRFAQËSORE TË SHQIPËRISË	20
3.3 SHKUMBINI DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ	22
3.4 FLORA DHE FAUNA	24
3.5 REZULTATET E ANALIZAVE (NËNTOR 2019)	25
4.0 SHËNDETI I MJEDISIT	33
5.0 LIGJI DHE KRIMINOLOGJIA MJEDISORE	37
6.0 PARIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE	39
6.1 HIERARKIA E MBETJEVE	39
6.2 AFËRSIA DHE VETËMJAFUESHMËRIA	41
6.3 NDOTËSI PAGUAN	41
6.4 OPSIONI MË I MIRË I ZBATUESHËM MJEDISOR	42
7.0 ANALIZA E MENAXHIMIT MJEDISOR	42
8.0 SHTOJCË	45
- DISA TË DHËNA NGA STAFI I BASHKISË ELBASAN	45
- HARTA ME PIKAT E GRUMBULLIMEVE INFORMALE	48
- TABELA E KOORDINATAVE	49
- SHOQATA ALBNATYRA	50

SHKURTIME

KMM	Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
NEA	National Environmental Agency
EPA	Environmental Protection Agency
EEA	Agjensia Evropiane e Mjedisit
ADZM	Administrata e Zonave të Mbrojtura
NJA	Njësi Administrative
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
IM	Inspektoriati Mjedisor
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara
EUROSTAT	Organizata Evropiane për Statistikat
BB	Banka Botërore
COD/NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
BOD/NBO	Nevoja Biologjike për Oksigjen
TSS	Lënda në Suspension/Pezull
Ptot	Fosfori Total

1.0 HYRJJE

Shoqata AlbNatyra në kuadër të Programit ReLOaD, faza II, ka marrë një grant nga UNDP dhe Bashkia Elbasan për një periudhë 9 mujore, korrik 2019 - mars 2019 për zbatimin e projektit “Ujra të Mbrojtura për Komunitete të Shëndetshme” në Bashkinë Elbasan. Objektivi i projektit është të gjejë një zgjidhje për problemin me qëllim përmirësimin e situatës aktuale të ndotjes në luginën e Shkumbinit nga mbetjet urbane nëpërmjet ndërgjegjësimit të komunitetit dhe hartimit të një raporti monitorimi me të dhënat e mbledhura në terren për t’u vënë në dispozicion të Bashkisë që të përdorë këto në punën e saj planifikuese dhe menaxhuese.

Për realizimin e këtij qëllimi është programuar studimi i gjendjes së problematikës, të trajtuar në projektpropozim, mbi të cilin hartohet ky raport. Duhet theksuar se raporti nuk ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e projektit në tërësi. Raporti përshkruan monitorimin/vëzhgimin e situatës lidhur me menaxhimin e mbetjeve në zonën e përzgjedhur si dhe vlerësimin e ndotjes në indikatorë sasiore dhe cilësorë të lumit Shkumbin në segmentin Xibrakë – Ura e Shkumbinit. Ky raport është përfundimtar për këtë fazë të projektit, i cili ndiqet me aktivitete të tjera sipas planit të punës të miratuar.

Raporti, së bashku me gjetjet që pasqyrojnë synon që të shtojë një ingranazh dinamik në gjithë ndërhyrjet dhe masat që duhen marrë për kultivimin e një kulture të duhur dhe të përgjegjshme, të popullsisë dhe institucionale, në trajtimin e mjedisit që na rrethon duke e parë atë në një këndvështrim më të gjerë se kufiri i shtëpisë, lagjes apo i vetë qytetit, si një përgjegjësi e përbashkët individuale, lokale dhe globale. Gjithashtu, raporti së bashku me kopjen fizike dhe elektronike të hartës me pikat e ndotjes, do të shërbejë si një doracak në marrjen e masave aty ku ka nevojë për ndërhyrje.

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Gjendja e tanishme në luginën e lumit Shkumbin, në segmentin e studimit, është një realitet me të cilën përballlet sot Shqipëria, dhe fatkeqësisht nuk lokalizohet vetëm në rrethin e Elbasanit. Prej 28 vitesh zhvillimet në vend me ndryshimet demografike, lëvizjen e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane, dhe rritja e dendësisë së banorëve në këto të fundit; hyrja në treg e produkteve me ambalazhe të ndryshme; rritja e konsumit; ngritja e bizneseve të vogla kryesisht

në rrugë kryesore dhe përgjatë lumit si dhe, mungesa e një infrastrukture menaxhimi për t'ju përgjigjur këtyre zhvillimeve, janë arsyt e një katastrofe të tillë mjedisore.

Në vitet e fundit janë ndërmarrë shumë nisma vullnetare apo dhe të mbështetura nga pushtetet vendore dhe qendrore për pastrimin kryesisht të bregdetit dhe në disa nisma edhe përgjatë lumenjve apo në zona që shërbejnë për aktivitete të rekreacionit, si piknik, hiking, etj. Këto nisma janë për t'u përshëndetur dhe mbështetur më gjerë, por është kuptuar që nuk janë të mjaftueshme dhe as zgjidhja përfundimtare e problemit.

Sipas një studimi nga EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) rreth 80% e mbetjeve që gjenden në det dhe oqeanë janë me origjinë tokësore. Burimi janë zonat rurale, qytete larg apo afër deteve dhe oqeanëve mbetjet e të cilave mbarten nga lumenjtë në derdhjet e tyre.

1.2 Bashkia Elbasan

Baseni i Lumit Shkumbin shtrihet në 6 qarqe, Korçë, Elbasan, Dibër, Tiranë, Durrës dhe Fier. Sipërfaqja totale e këtij baseni është 2'728.3 km² (tabela 1. fq.,4)¹. Bashkia e Elbasanit i jep këtij baseni një sipërfaqe prej 872.1 km². Llogaritur në % kjo zë 31% të të gjithë sipërfaqes. Në nivel qarku, Qarku i Elbasanit përfshin një sipërfaqe të pellgut të Shkumbinit prej 2'519.9 km², ose



92.1%. Sipas po të njëjtit raport nga është marrë dhe sipërfaqja totale e basenit të lumit jepet që numri i banorëve të cilët banojnë përgjatë basenit të lumit llogaret me afërsi 413,293 banorë. Popullsia e Bashkisë së Elbasanit për vitin 2018²

llogaritet me 212'628 banorë, dhe përbën 50.4 % të të gjithë popullsisë së 6 qarqeve nga kalon lumi Shkumbin. Në këtë llogaritje përfshihen banorët e Bashkisë Elbasan, Bradashesh dhe Gracen, Labinot Fushë, Labinot Mal, Shushicë, Tregan, Gjinar dhe Zavalinë, Gjergjan, Papër,

¹ IBECA Project:

http://ibeca.al/pages/docs/Shkumbini%20River%20Basin%20Management&Climate%20Change%20Adaptation%20Plan_ENG_Final.pdf

² <https://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx>

Shirgjan dhe Funarë. Në monitorimin tonë janë përfshirë 14 fshatra që u takojnë Njesisë Administrative Shushicë dhe Labinot Fushë.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Elbasan realizohet në dy forma dhe me institucione përgjegjëse të ndara. E para është për NjA-ve ku përfshihen NjA-të, Papër, Bradashesh, Gjergjan, Shirgjan, Tregan, Gjinar, Labinot Fushë dhe Shushicë. Dy nga të cilat janë objekt edhe I projektit tone. Dhe forma e dytë, siç i referhet Bashkia, është për Bashkinë e Elbasanit ose zonën urbane.

Bashkia Elbasan nuk ka ende një impiant trajtimi të ujërave të zeza. Qyteti i Elbasanit është i lidhur me një sistem ujrash të zeza së bashku me ato të shirave dhe të ujërave urbane të cilat shkarkohen në lumin shkumbin. Shtatë nga 9të shkarkimet kryesore derdhen në Shkumbin, dhe dy të tjerat në lumin e Zaranikës. Ndërsa zonat rurale janë pa sistem dhe ujrata derdhen direkt në përroit më të afërt ose në lum. Ky ishte dhe një nga shqetësimet që ngritën banorët e fshatit Mlizë ku na shpjeguan se me ujin e përroit nuk mund të ujisin më tokat pasi është shumë i ndotur nga ujrata e zeza dhe gjithë shkarkimet e tjera. Me mbështetjen e BB po realizohet studimi i mundësive të trajtimit të ujërave ujrata ndotese të bardha dhe të zeza të bashkive të vendosura përgjatë brigjeve lumit Shkumbin, kjo është në kuadër të Programit të Qeverisë Shqiptare në zbatim të 17 Objektivave të ZHVillimit të Qëndrueshëm.

Përveç ndotjes nga mbetjet e ngurta, ujrata e zeza dhe urbane, pesticide/herbicide nga veprimtaria bujqësore merren në shqyrtim edhe ndotjet industriale dhe kjo ka qenë mjaft e rëndësishme për qytetin e Elbasanit. Metalurgjia, miniera, ndërtimi janë midis industrive të cilat kanë ndikim më të madh në ndotjen e lumit Shkumbin.

Më kapituj në vijim do të shohim që lumi Shkumbin, në kohën kur Metalurgjiku funksiononte me kapacitet të plotë, nga derdhjet e metalurgjikut konsiderohej si lum i vdekur pas kësaj pike. Këto industri janë në zhdukje ose duke u zvogëluar në veprimtarinë e tyre nxjerrëse dhe përpunuese por sigurisht që janë ende domethënëse në këtë këndvështrim. Ajo që vihet re shpesh në grumbullimet informale janë inertet pasi ndërtimi ka njohur një rritje dhe ristrukturimi i shtëpive apo ndërtimi i tyre sa më afër lumit ka çuar në shtim të kësaj mbetje.

Qarku i Elbasanit ka pasuri të shumta minerare dhe kjo është njohur që në kohën e perandorisë Romake. Në këtë qark ka pasuri të mineralit të kromit, hekur-nikelit, etj. Një pjesë e madhe e këtyre minierave janë të mbyllura tashmë. Përveç këtyre marrja e zhavorrit në shtratin e lumit

Shkumbin është një faktor tjetër që ndikon në shëndetin e lumit por që ka dhe pasoja të tjera mjedisore, kjo kryhet më shumë në segmentin e lumit që është pjesë e Librazhdit, pasi në gradualisht në Shkumbini kalon në lum fushor duke u futur në Elbasan.

Bashkia Elbasan shtrihet në zonën qendrore të vendit dhe përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Shkumbin, lumi i Gostimës, lumi i Zaranikës, Kushës dhe Zalli i Papërit që janë njëkohësisht dhe ushqyesit kryesorë të Lumit Shkumbin. Në territorin e kësaj Bashkie numërohen një sërë monumentesh kulturore, historike dhe natyrore. Gjatë monitorimit tonë patëm mundësinë të vizitonim Kishën e Shënkollit³ që ndodhet në krahinën e Shpatit, në fshatin Shelcan, në njësinë administrative Shushicë. Kjo është dhe zona nga ku vijnë dy piktorë të ikonografisë pasbizantine të shekullit XVI, Onufri dhe shekullit XVIII Konstandin Shpataraku. Kjo kishë është ndërtuar para pushtimit Osman dhe është shpallur Monument Kulture. Gjithashtu, në Polis Valë kemi hasur monumentin natyror “Frashëri i Zi”, e shumë të tjera të shprehura me VKM nr. 676, datë 20.12.2002 ku është bërë një rivlerësimi i këtyre pasurive duke bërë dhe pakësime edhe shtesa, si dhe janë miratuar gjeomonumentet, sipas propozimeve të bëra nga DSh Pyjor Elbasan, lista si më poshtë:

♦ **Biomonumente të kategorisë “B”:**

1. Pylli i Mështeknës në Zavalinë, me sipërfaqe rreth 7,5 ha.

♦ **Biomonumente të kategorisë “C”**

1. Pylli i Rrobullit të Zeleshnjës në Gjinar me sipërfaqe 1,5 ha.
2. Frashëri Polis-Valë.
3. Dushku i Lleshanit.
4. Lisat e kishës së Pashtreshit.
5. Pisha e Fushë-Kuqes me sipërfaqe 2 ha
6. Rrapet e Byshekut me sipërfaqe 0,40 ha.
7. Rrapi i Gurrës në Labinot-Mal
8. Rrapi i Bezistanit

³ Instituti i Monumenteve të Kulturës

9. Rrapi i Vojvodës

♦ Rezervë natyrore e manaxhuar e kategorisë “IV”.

1. Zona e mbrojtur Qafë-Bushi (Qarret) me sipërfaqe 582,5 ha.

♦ Gjeomonumente të kategorisë “B”

1. Shpella e Gracenit.

2. Burimi i Llixhës së Hidrait.

♦ Gjeomonumente të kategorisë “C”.

1. Shpella e Letanit.

Në këtë zonë kalon dhe Via Egnatia me vlerat e saj historike ku në disa segmente gjenden ende pjesë të kalldrëmit të vjetër. Gjinari njihet tashmë dhe frekuentohet për vlerat e tij turistike kryesisht për ngjitje malore si dhe hoteleri-turizëm, po ashtu ia vlen të përmendet edhe Funara që ka një potencial mjaft të madh për zhvillimin e eko-turizmit, e shumë të tjera që kërkojnë vëmendjen e duhur për investim dhe promovim të një turizmi mbarëvjetor.

Këto vlera kulturore, historike dhe turistike kërkojnë një angazhim të vazhdueshëm për ruajtjen dhe promovimin e tyre si dhe krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve dhe turistave vendas dhe të huaj.

2.0 Rezultatet e Monitorimit në terren

Në projektpropozim janë përfshirë në studim dy Njësitë Administrative të Shushicës dhe Labinot Fushë ku, gjithsej përfshihen 14 fshatra. Njësia e Shushicës ka 11,507 banorë dhe Labinot Fushë 6,928 banorë⁴. Të dyja këto njësi shtrihen përgjatë luginës së lumit Shkumbin dhe zënë një segment të konsiderueshëm të gjatësisë së tij brenda Bashkisë Elbasan në pjesën lindore të saj. Përveç veçorive pozitive që ky lum ka shërben njëkohësisht edhe si transportues i mbetjeve nga përrrenjtë apo brigjet e tij përgjatë gjithë rrjedhës deri në derdhjen në Adriatik. Të gjitha fshatrat brenda këtyre njësive janë pa sistem disiplinimi të ujrave të zeza, ndërsa profili i menaxhimit të mbetjeve urbane ishte i ndryshëm në fshatra të ndryshme ku kemi hasur dhe shembuj majft pozitivë dhe që vlejné të bëhen të njohura si dhe të zbatohen edhe në zona të tjera. Më poshtë jepet harta e zonës së studimit.

FIG.1 ZONA E STUDIMIT MIDIS DY VIJAVE TË VERDHA




Objektivat e vendosur në këtë monitorim ishin:

- ─ Të identifikojë grumbullimet informale në fshatrat e studimit;
- ─ Të regjistrojë në sistemin e gps këto pika dhe t'i dokumentojë me fotografi;

⁴ <https://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx>

Të vëzhgojë sistemet e shkarkimit të ujërave të zeza;

- └ Të bëhet vlerësimi sasior i grumbullimit nëse kjo është e mundur;
- Të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së mbetjeve;



Monitorimi nisi në muajin korrik në njësinë administrative Shushicë. Në këtë monitorim u përfshi i gjithë stafi i AlbNatyres. Paralelisht me vëzhgimin në terren, dokumentimin e dhënave u realizuan dhe takime mjaft të vlefshme për objektivin e këtij projekti.

Janë takuar kryetarë të Njësive Administrative dhe banorë të këtyre fshatrave për të diskutuar më gjerë për problematikën, shkaqet dhe çfarë zgjidhjesh janë dhënë.

Në çdo bisedë ndihet që ndotja është shqetësim edhe për vetë banorët të cilët, në rastet ku nuk ofrohet shërbim i hedhin ato në disa pika përgjatë përrenjve dhe lumit. Fshati Fush Buall edhe pse vendodhjen e kishte idilike në një natyrë të bollshme dhe të gjelbëruar brenda tij gjeje vetëm plehra. Ky fshat dukej i harruar në atë rrënzë malesh ku kishte mbirë, por edhe banorët nuk ishin shumë të përkushtuar ndaj pastërtisë së fshatit. Në këtë rast bëhej e pamundur të vlerësohej dhe sasia e mbeturinave sepse ato ishin të shpërhapura në çdo rrjedhë të mundshme ujore që përshkronte fshatin.

Një shembull mjaft pozitiv ishte fshati Mlizë dhe Shushicë (Foto.2) jep kamionin që mbledh plehrat në çdo familje, kjo dallohet sepse ambalazhi i tyre është me qese). Banorët mblidhnin mbeturinat në qese dhe i vendosnin ato në një kosh të krijuar vetë në portën e shëpisë dhe në një ditë të caktuar kalonte makina dhe i mblidhte. Banorët paguanin personin që mblidhte këto mbeturina nga 100 lekë për familje në muaj. Në përgjithësi Njësia Administrative e Shushicës rezultonte e pastër, përveç disa rasteve si në Fush Buall dhe disa pika të tjera me grumbullime informale të cilat janë regjistruar dhe hedhur në hartën që paraqitet në fund të këtij raporti. Në këtë njësi nuk kishte kosha mbeturinash të vendosura nga Bashkia. Fshati Shelcan e ngriti këtë shqetësim sepse ata nuk kishin një sistem mbledhës dhe ende nuk kishin dakordësuar që

dikush ti mbledhë ato si në rastin e Mlizës dhe Shushicës. Ato i grumbullonin në një pikë dhe i digjnin për një lagje dhe të tjerët përdornin përrrenjtë për ti hedhur ato.

Njësia Administrative Labinot Fushë paraqiste një panoramë tjetër më shqetësuese. Një fenomen i çuditshëm është që kudo që ndodhen koshat ka edhe më shumë mbeturina përreth. Kjo duket edhe në fotot më poshtë të cilat janë bërë në fshatrat përgjatë rrugës kryesore ku dhe janë vendosur kosha nga Bashkia. Mengel, Labinot Fushë dhe Xibrakë kishin gjithëandej mbeturina të shpërhapura si dhe depozitime përgjatë urave dhe përrrenjve, edhe pse koshat ishin funksionalë.

Foto ilustruese përgjatë monitorimeve të kryera:



Foto. 1



Foto. 2



Foto. 3



Foto.4



Foto. 5



Foto. 6



Foto. 7



Foto. 8



Foto. 9



Foto. 10



Foto. 11



Foto. 12



Foto. 13



Foto. 14



Foto. 15



Foto. 16

Ndërsa, nga vlerësimi i përmbajtjes së mbetjeve arrihej në përfundim se konsumi në zonat rurale që kanë dhe një standard më të mirë jetese, është i përafërt me ato urbane. Në këto grumbullime gjeje ambalazhe të pothuaj 80- 90% të produkteve që janë në tregun ushqimor, ky vëzhgim është hasur edhe në fazën e parë të projektit për Bashkinë Librazhd. Shpesh gjendeshin edhe mbetje organike, të bahçeve si degë të thara, gjethe, etj, të hedhura bashkë

me materialet e tjera çka e bën të nevojshme një fushatë ndërgjegjësimi se si ti trajtojnë këto mbetje pa qenë nevoja e hedhjes me të tjerat.

Në këtë vëzhgim ashtu si në fazën e parë të projektit për Bashkinë Librazhd inertet ishin shumë të pranishme në shumë depozitime.

Bashkia duhet të marrë masa për këtë kategori për krijimin e pikave të vençanta për grumbullimin e tyre me qëllim që të ripërdoren dhe të mos rrinë përgje përgjatë rrugëve të fshatit apo buzë përrenjve. Në një përllogaritje të përafërt sipas monitorimit të kryer pasqyrojmë në grafikun vlerat në përqindje të përbërjes së mbetjeve të depozituara. Mbetjet organike të cilat janë sërish prezente tregon që fushatat e ndërgjegjësimi janë të nevojshme si dhe edukimi me praktika të mira ndarje dhe kompostimi.

GRAFIKU.1 PËRMBAJTJA E MBETJEVE





FIGURA.1: REZULTATET E MONITORIMIT



Në 14 fshatrat e përfshira në monitorim, zyrtarisht janë 15 duke llogaritur Shushicën, Hajdaraj, Mlizë, Shelcan, Fush Buall, Polis i Vogël, Polis Valë, Vasjan, Vreshtaj, Mengel, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan Poshtë, Labinot Fushë dhe Xibrakë, Vasjani nuk është përfshirë si emër në projekt propozim pasi kanë mbetur vetëm 2 familje nga shpërnguljet që kanë ndodhur në fshat.

Harta më lart shpreh shpërndarjen e pikave informale të grumbullimit të mbetjeve të cilat janë regjistruar në momentin e kryerjes së monitorimit në muajin korrik, 2019. Ndër këto kishte dhe pika të cilat shërbenin për djegjen e mbeturinave sipas familjeve apo lagjes përreth, aty kishte vetëm gjurmë të djegjes. Përroi Manazeres ishte i ndotur përgjatë gjithë rrjedhës së tij. Në fillim të rrugës ka kosha, mbetjet e të cilëve ishin të gjitha jashtë, Foto.11-16, dhe përveç këtyre edhe depozitime në trupin uhor të përroit.

Hasëm dhe iniciativa të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, si kanaçe, në monitorimin e kryer në fshatin Godolesh, Foto.9.

Në Xibrakë, Foto.7, buzë përroit që ishte afër shkollës ishte një depozitim i madh mbetjesh, një pjesë e të cilave merreshin nga uji në kohë shirash dhe rritje të nivelit të shtratit. Këto mbetje e kishin origjinën nga shkolla dhe lokali ngjitur dhe shërben si një shembull jo i mirë edukimi për brezat e ardhshëm.

Përveç mbetjeve urbane, cilësia ujrave është një shtetësim. Qyteti i Elbasani siç përmendëm më lart shkarkon ujrata e zeza dhe urbane në 9 pika, 7 në lumin Shkumbin dhe 2 në Zaranikë, kjo e fundit derdhet në Shkumbin. Pra përveç ndotjeve urbane këto shkarkime kanë ndikime në cilësinë e ujrave sepse përveç përmbatjes organike lëndët kimike nga detergjentë dhe materiale të tjera higjienike i shtohen ujit të lumit. Sipas Direktivës 91/271/EEC ndotja nga ujrata urbane mund të përcaktohet në bazë të vlerave në gram për 1 person në ditë, që janë: NBO5= 60g, Nt = 11g, Pt=2.8 g. Për një popullsi prej 130'444 të qytetit Elbasan ngarkesa në 1 vit do ishte:

$$NBO5 = 2'856'723 \text{ PE}^5/\text{vit (ton)},$$

$$Nt = 523'732 \text{ PE/vit (ton)},$$

$$Pt = 133'313 \text{ PE/vit (ton)}.$$

Këto janë vlera të konsiderueshme të ndotjes me këtë popullsi për këtë segment të lumit.

⁵ Person Ekuivalent: Vlerë që aplikohet në BE

3.0 Vlerësimi i cilësisë së ujit të lumit shkumbin

3.1 RËNDËSIA E LUMIT

Lumi duhet konsideruar si një subjekt ligjor. Ai ofron një sërë të mirash për komunitetet përreth tij dhe për mjedisin. Lumenjtë sigurojnë ujë të pijshëm, krijojnë mikroklima, kontribuojnë në kapjen e karbonit, mbartin një sërë specimesh të gjalla dhe florë të pasur. Dobitë më pak të dukshme, por po aq të prekshme nga një lumë i egër përfshijnë transportin e sedimenteve dhe ushqyesve që mbështesin komunitetet biologjike. Baticat bregdetare në grykëderdhjen e lumenjve krijojnë një ndër ekosistemet ujore më produktive, duke siguruar një habitat për shumë lloje specimesh.

Disa lumenj kanë vlera të llogaritshme ekonomike dhe disa të tjerë janë disa hapa larg nesh në zinxhirin e ushqimit. Lumenjtë kanë një potencial të fortë ekonomik si në bujqësi, në sektorin e industrisë, energjisë dhe sigurimin e inerteve në ndërtim, etj.

Por nesë do i shihnim lumenjtë vetëm në aspektin ekonomik, psh., atë energjetik, atëherë do duhej t'u vendosnim të gjithëve një tub për të drejtuar ujin nga turbinat për të prodhuar energji elektrike. Vlera e menjëhershme ekonomike e së cilës është padyshim më e lartë se sa peshqit, butakët apo shpendët që prodhohen nga i njëjti lumë në gjendjen e tij të egër. Kjo ndodh dhe mund të vazhdojë të ndodhë nëse lejohet që nocioni i vlerës të përcaktohet ekskluzivisht nga vlera e tregut. Ndaj, sot mjedisi has në shumë sfida të cilat janë kthyer si një monstër me shumë koka ku çdo kokë do ishte: ndryshimi klimaterik, shpyllëzimi global, mungesa e qasjes në ujë të pastër, përdorimi industrial i kimikateve toksike, etj.

Trajtimi i lumit si një subjekt ligjor me gjithë të drejtat mjedisore që i takojnë është më tepër se një çështje ekonomike, e cila lidhet ngushtë me etikën mjedisore. Dhe është e kuptueshme që perceptimet e ndryshme të një problemi të caktuar nuk janë domosdoshmërisht për shkak të keqkuptimeve të natyrës së problemit, por janë për shkak të perspektivave të ndryshme etike-mjedisore, se si i perceptojmë ato ne si shoqëri.

3.2 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PASURIVE UJORE SIPËRFAQËSORE NË SHQIPËRI

Shqipëria renditet si një nga vendet e para të Evropës për sa i përket sasisë së ujit për frymë të popullsisë. EUROSTAT në vitin e fundit renditi Shqipërinë të 3-tën në Evropë, pas Norvegjisë dhe Finlandës, për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme hidrike. Sipas Eurostat, në vitin 2016 kur është bërë studimi, 85% e energjisë të prodhuar në Shqipëri vinte nga burime natyrore, ndërkohë që në Evropë mesatarja rezultonte me 30%.

Në raportin 'Pasuritë Ujore Shqiptare' pasqyrohet një përmbledhje e këtyre burimeve ujore, nëntokësore dhe sipërfaqësore. Shqipëria është një vend malor dhe për shkak të veçorive morfologjike është shumë e pasur në lumenj. Më shumë se 152 lumenj dhe përrenj, formojnë përfundimisht 8 lumenj të mëdhenj, që rrjedhin nga lindja drejt perëndimit, kryesisht drejt bregdetit Adriatik. Rreth 65% e pellgut ujëmbledhës të tyre shtrihet brenda territorit shqiptar (Kabo, 1990- 1991; fig. 1-1). Këta lumenj shkarkojnë në detin Adriatik mesatarisht 1'308 m³/s (min. 649 dhe maks. 2'164 m³/s); moduli mesatar i rrjedhjes është 30.2 l/s . km². Nga prurja e përgjithshme vjetore prej 42.25 miliardë m³, vetëm 12.8 miliardë u përkasin ujërave nëntokësore.

Prej reshjeve të çrregullta, me ndryshimet klimaterike kjo është bërë akoma më e paparashikueshme, lumenjtë janë të rrëmbyeshëm, gërryes (në pjesën lindore të vendit) dhe përgjithësisht formojnë shtrat të gjerë dhe të lakuar në Ultësirën Bregdetare Perëndimore. Si rrjedhojë në shtratet e disa lumenjve, siç është edhe Shkumbini objekt i projektit tonë, vihet re theksueshëm fenomeni i erozionit. Ky fenomen që kërcënon ekosistemet natyrore vjen dhe si rezultat i shpyllëzimit në masë në 30 vitet e fundit, mirëmbajtja e argjinaturave është gjithashtu për t'u konsideruar, si dhe shfrytëzimi i inerteve jokonform rregullave mjedisore.

Sipas po këtij raporti, monitorimi i cilësisë së ujërave në Shqipëri ka filluar prej vitit 1988 në 8 lumenj të mëdhenj, dy herë në vit, në rreth 20 stacione. Për shkak të monitorimit të çrregullt, kryesisht gjatë periudhës 1990 deri 1996, për krahasim me matjet e bëra gjatë zbatimit të këtij projekti u përpoqëm të gjejmë të dhëna nga vitet e mëparshme, për fat të keq nuk gjenden të dhëna edhe për arsye të mospublikimeve asokohe. Në tabelat më poshtë po paraqesim disa matje nga Komiteti Mbrojtjes së Mjedisit (KMM/CEP, 1995-1996), më vonë nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM/NEA, 1997-1998), si dhe matjet e kryera në vitin 2003 të paraqitura në një raport të A. Cullaj "et al. / *Environment International* 31 (2005) 133–146".

Vlerat e disa parametrave për vitin 1996, KMM (Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit)

Nr.	Stacioni	O2 tretur	COD	BOD	Amonium	Nitrate	Silikate	Ptot mg/l
1	Shkumbini 1	8.32	0.52	1.11	0.09	1.2	18	0.11
2	Shkumbini 2	6.69	1.2	4.3	0.3	0.7	23	0.1

Vlerat e disa parametrave për vitin 1997-98, KMM (Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit)⁶

(Labinot, Papër dhe Rrogozhinë-stacionet)

Nr.	Stacioni	COD		BOD		Ptot		NO3-	
		1997	1998	1997	1998	1997	1998	1997	1998
1	Shkumbin 1	1.5	0.48	1.1	1.1	0.9	0.6	0.08	1.15
2	Shkumbin 2	1.5	0.64	0.74	1.51	0.32	0.47	0.3	0.05
3	Shkumbin 3	2	0.64	1.48	1.7	0.45	0.45	1.01	0.05

Verat krahasuese 1995-96 dhe 2013 (Raporti: The quality of Albanian natural water and the human impact ⁷)


Nr.	Stacionet & dhe periudha e monitorimit	NH4 +	NO3	NO2	TSS
1	Shkumbini (Cullaj et al., 2003)	0.2–1.0	3.1–204.6	0.01–0.2	31–328
2	Shkumbini (KMM, 1995–1996)	0.05–0.30	0.7–1.2	0.01–0.05	136–456

AKM (Agjensia Kombëtare e Mjedisit) ka të publikuara të dhënat edhe për vitet 2010 deri në 2015, si dhe raportin e botuar në vitin 2014 mbi një monitorim të kryer në gjithë lumenjtë e Shqipërisë ku janë nxjerrë rezultatet më poshtë. Lumi Shkumbin, në këto raporte, qëndron

⁶ http://37.139.119.36:81/publikime_shkencore/ALB-RIVERS-WEB-PDF/009-28-Kreu1-Ujerat-Shqiptare.pdf

⁷ A. Cullaj et al. / Environment International 31 (2005) 133–146

pak a shumë në të njëjtin nivel për parametrat e matura, por duhet vërejtur se mungojnë metalet e rënda dhe stacionet e matjeve janë përtej segmentit tonë të studimit. Kjo vihet re edhe nga vitet e mëparshme ku parametrat e matur ndryshojnë, nuk ka një qëndrueshmëri në çdo raportim. Për krahasim këto vlera janë të dobishme për të krijuar një historik të jetës së lumit.



Grafiku pasqyron gjendjen e përgjithshme të lumenjve në Shqipëri:

Vlerësimi, sipas raportit të 2014, është bërë në shkallën I deri V, nga: shumë mirë, mirë, moderuar, keq dhe varfër, në bazë të normave të shpallura në direktivën e ujit të BE-së.

Lumi Shkumbin qëndron në kategorinë III, me vlera të moderuara të ndotjes.

Cilësia	Mat, Vjosa	Drini, Buna, Erzen, Shkumbin, Seman	Drin, Lezhë	Ishëm	Gjanica	%
I						0
II	II					20
III		III				50
IV			IV			10
V				V	V	20

3.3 SHKUMBINI DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Shkumbini është nga lumenjtë më të mëdhenj në Shqipërinë Qendrore. Është 181 km i gjatë, sipërfaqja e pellgut 2'444 km², dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 753 m (Kabo, 1990-91). Grykëderdhja e tij është në detin Adriatik, në pjesën jugore të lagunës së Karavastasë. Shkumbini buron nga pjerrësitë lindore të Valamarës dhe malet e Gurit të Kamjes. Në luginën e Elbasanit, shtrati i tij zgjerohet dhe rrjedh drejt perëndimit deri në fushën bregdetare në afërsi të Rrogozhinës, ku transformohet në lumë fushor.

Në pellgun e Shkumbinit ka larmi gëlqerorësh, nga ku burojnë shumë burime karstike të rëndësishme, si ai i Krastës me 500 l/s. Prurja mesatare shumëvjeçare e Shkumbinit është 61.5

m³/sek. Ai transporton mesatarisht 5.8 milionë tonë lëndë të ngurta në vit. Temperaturat lëvizin nga 6.3°C në janar deri 22°C në gusht. Mineralizimi i ujërave është rreth 317 mg/l.

Përgjatë basenit të lumit Shkumbin, nga burimi deri në dalje të detit Adriatik, jeton një popullsi⁸ prej 413'293 banorësh.

Studimet, siç e pamë dhe më lartë, tregojnë cilësi relativisht të mirë të ujërave, kategoria III. Megjithatë, Shkumbini ka qenë dhe mbetet lumë me probleme mjedisore. Veçanërisht ndikim të madh kanë luajtur mbeturinat e shkarkuara nga Kombinati Metalurgjik i Elbasanit. Sasi të mëdha të lëndëve ndotëse janë shkarkuar drejtpërdrejt në lumë, ndërsa në brigje janë hedhur sasi të mëdha mbeturinash të ngurta nga aktivitetet e Kombinatit. ⁹Para viteve 1991, është vlerësuar që prej këtij objekti industrial janë shkarkuar në Shkumbin 30-35 milionë m³/vit mbeturina të lëngëta me përmbajtje shumë të madhe të lëndëve helmuese si: cianuret, fenolet, NH₃ etj.

Gjithashtu, në brigjet e tij shkarkoheshin rreth 800 t në ditë mbeturina të ngurta (Cake, 1996). Dhe, nga ndotja e rëndë industriale, lumi Shkumbin poshtë qytetit të Elbasanit vlerësohej në një lumë të vdekur. Pas vitit 1990 kur shumica e objekteve industriale ndërprejnë aktivitetin duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e ujërave. Sot problematikës i shtohen mbetjet urbane të shpërndara gjatë rrjedhës së lumit, qese dhe plastika të varura nëpër shkurre. Lumit i është ngarkuar përgjegjësi e transportit të mbetjeve për në det të hapur. Nga kjo analizë është i dukshëm shqetësimi nga:

- 1 shkarkimet të urjave urbane të qytetit të Elbasanit, Librazhd dhe Prrenjasit, pasi lumi kalon pranë tyre dhe grumbullon gjithë shkarkimet e patrajtuara;
- 2 shkarkimet industriale, si nga aktivitetet e tanishme ashtu dhe nga grumbullimet në brigje të shkarkimeve të ngurta të mëparshme;
- 3 erozioni i lartë në basenin ujëmbledhës prej shpyllëzimeve;
- 4 shkarkimet dhe kimikatet me origjinë bujqësore, pasi lumi kalon në zonë me bujqësi pak a shumë të zhvilluar. Theksojmë se Shkumbini ka ndikim të drejtpërdrejtë në lagunën e Karavastasë, zonë mjaft e ndjeshme, zonë veçanërisht e mbrojtur (zonë Ramsar dhe Park Kombëtar); dhe,
- 5 shkarkimet e mbetjeve urbane- objekti i studimit tonë.

⁸ IBECA Project:

http://ibeca.al/pages/docs/Shkumbini%20River%20Basin%20Management&Climate%20Change%20Adaptation%20Plan_ENG_Final.pdf

⁹ http://37.139.119.36:81/publikime_shkencore/ALB-RIVERS-WEB-PDF/009-28-Kreu1-Ujerat-Shqiptare.pdf

3.4 FLORA DHE FAUNA

Karakteristike të florës ujore përgjatë pellgut të Shkumbinit janë algat dhe bimët e larta. Duhet theksuar se dallojmë dy tipe të ndryshme të florës: atë ujore (algat, etj.) dhe bimësinë përgjatë brigjeve të lumit. Në brigje vërejmë që rrapi gjendet në gjithë zonën e vëzhguar. Po kështu shelgu, plepi dhe disa lloje të tjera janë prezente në disa pjesë të lumit dhe shkurret si rakita gjenden kudo, gjithashtu dhe shumë lloje barishtoresh. Experti Hasan Deliu, Ing.Pyjesh, pranë AlbNatyra ka përgatuar në paragrafët më poshtë një përmbledhje të pasurisë së florë në shtratin e lumit Shkumbit duke e ndarë në dy kategori:

a. Flora drunore: **Rrapi** (*Platanus orientalis* L.), **Plepi i zi** (*Populus nigra* L.), **Shelgu** (sp.), **Shtogu i zi** (*Sambucus nigra* L.), **Ushinthe** (*Pyracantha coccinea* Roem., *Crataegus pyracantha* Borch.), **Marina** (*Tamarix* L. sp.), **Manaferra** (*Rubus ulmifolius* Schott., *R. fruticosus* L.), **Lajthia e butë** (*Corylus avellana* L.), **Kulpra** (*Clematis* L. sp.), **Konopica** *Vitex agnus-castus* L. (*V. trifolia*), **Akacia** (*Robinia pseudoacacia* L.), **Arra** (*Juglans regia* L.) etj.

b. Flora barishtore: **Bar blete** (*Melissa officinalis* L.), **Bari i majasëllit** (*Teucrium polium* L.), **Hithra** (*Urtica dioica* L.), **Idhnakthi i zi** (*Solanum nigra*), **Qingla** (*Sambucus ebulus* L.), **Gjethe delli** (sp.) etj.

Fauna e ekosistemeve lumore ka karakteristikë peshqit, butakët dhe zogjtë e egër. Për këtë do t'u referohemi dy studimeve të kryera në distancë një në vitin 1996 dhe një më i afërt që është një studim i vitit 2015. Kjo mund të konsiderohet si fat për Lumin Shkumbin sepse në përgjithësi studimet kanë qenë të rralla për lumenjtë, por ndryshimet klimaterike dhe sigurimi i ujit me cilësi të mirë që siguron një mjedis të shëndetshëm për banorët dhe për botën e gjallë lumore dhe atë detare, ka sjellë një vemendje duke hartuar studime të këtij lloji.

Gjatë fazës para përgatitore të projektit për segmentin e lumit në Bashkinë Librazhd, në grupin e diskutimit kishim të ftuar dhe peshkatarë të apasionuar të zonës, të cilët na vunë në dijeni se disa lloje peshqish nuk hasen më në lum prej disa vitesh, si edhe në disa përrenj ushqyes të lumit ato nuk gjenden më.

Nga raporti i pasurive të ujrave natyrore në Shqipëri kemi hasur si vijon: *Në një vlerësim ekologjik për lumin e Shkumbinit, Cake (1996) ka gjetur rreth 17 lloje peshqish që i përkasin familjes Cyprinidae dhe rreth 115 lloje diatomes (Miho et al., 2003). Rreth 8 lloje i përkasin listës së llojeve të rralla dhe të rrezikuara. Shkumbini në pjesën e sipërme të tij ofron kushte të mira strehimi për pesë prej tyre, Barbus graecus, B. meridionalis ssp. peteneyi, B. meridionalis ssp. rebeli, Nemachilus barbatulus ssp. sturanyi dhe Pachychilon pictum, ky i fundit është një*


Iloj endemik i detit Adriatik. Katër llojet e tjera, Cobiti taenia ssp.taenia, Gobio gobio ssp. albanicus, trofta malore (Salmo trutta ssp.macrostigma, tërësisht e kërcënuar; pasqyra 4-7) dhe Gobio gobio ssp. lepidolameus, gjithashtu të rralla, janë gjetur përgjatë lumit të Shkumbinit (Cake & Miho, 1999)¹⁰.

Në studimin e viti 2015¹¹ mbi akuakulturën e lumit Shkumbin renditen 16 lloje species: Alburnoides bipunctatus, Anguilla anguilla, Alburnus sp., Barbus prespensis, Cobitis ohridana, Gobio Gobio, Oxynoemacheilus pindus, Pachichilon pictum, Pseudorasba parva, Squalius cephalus, Rutilus rubilio, Salmo faroides, Gambusia affinis, Mugil cephalus dhe Liza ramada. Tre nga këto specie janë të huaja/invazive për këtë ekosistem. Shkumbini shërben dhe si një korridor migrimi për disa lloje peciesh si ngjala (Angilla anguilla). Por, këto specie ndihen të kërcënuara nga ndërtimi i HEC-eve të cilat ndërpresin migrimin e tyre. Anguilla anguilla futet në listën kritike të zhdukjes.

3.5 REZULATET E ANALIZAVE (SHTATOR- NËNTOR 2019)

Tashmë është krijuar një njohuri e plotë mbi historikun e gjendjes së lumit Shkumbin. Për ta aktualizuar me situatën sot janë marrë kampione uji në 3 pika, brenda Bashkisë Elbasan dhe janë përpunuar rezultatet respektive. Në hartën më poshtë paraqiten vendet ku janë marrë kampionet: 1. Ura e Polisit, 2. Ura e Shkumbinit dhe 3. Papër. Vlerësimi i cilësisë së ujit të lumit përcaktohet në bazë të disa parametrave kryesorë fiziko-kimikë si në tabelën që vijon më pas, të përpiluara nga Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan.

FIGURA. 2: HARTA E MARRJES SË KAMPIONEVE



¹⁰ "Pasuritë Ujore Shqiptare"

¹¹ Prof. Dr. S.Shumka "Shkumbini river_Fish_September 2015"

Gjatë marrjes së kampioneve për analiza në tre pikat e mësipërme:




TABELA. 2: REZULTATET E ANALIZAVE

Nr.	Analiza	Pika 1	Pika 2	Pika 3	Norma ¹²
1	N-NH ₃	0	0.68	0.01	<0.10 mg/l
2	Nitrite (NO ₂ -)	0	0.04	0.03	<0.50 mg/l
3	Nitrate (NO ₃)	0.8	2	2.3	<50 mg/l
4	PO ₄ ⁻³	0.17	0.4	0.17	<0.1 mg/l
5	Ptot	0.5	0.4	0.3	<0.7 mg/l

¹² Normat e shpallura me VKM Nr.379, datë 25.05.2016

Rezultatet e pasqyruara në tabelë i kemi hedhur në grafik për të bërë një krahasim se si vijon trendi i ndotjes ndërkohë që lumi futet në territorin e qytetit të Elbasanit. Pika e parë, tregon nivele më të ulta të ndotjes krahasuar me dy pikat e tjera, brenda dhe jashtë qytetit të Elbasanit në krahun perëndimor. Pika e tretë, pasi kemi dalë nga qyteti i Elbasanit dhe pas metalurgjikut tregon një rritje të këtyre vlerave. Në vijim kemi paraqitur edhe një shpjegim për çdo parametër se si ndikojnë këto në toksicitetin e ujit.

GRAFIKU.2 TRENDI I NDOTJES NË ZONËN E MONITORIMIT



Stafi i AlbNatyres ka vazhduar me monitorimin e cilësisë së ujrave edhe pas marrjes së kampioneve të analizave të mësipërme duke matur vlerat e pH, temperaturës dhe konduktivitetin. Ky monitorim do të vazhdojë përgjatë gjithë zhvillimit të projektit për të ndërtuar një databazë të dhënash. Monitorimi është ndërprerë në periudhën e shirave dhe do vijojë sërish. Më poshtë po japim foto ilustruese dhe të dhënat e matura.

Gjatë matjes së cilësisë së ujit me sonda:



	pH	Temperatura (°C)	Konduktiviteti (µs/cm)
Kampioni 1	7.5	15.9	363
Kampioni 2	7.2	14.9	409
Normat	>6.8-9.5<	15°C	[150, 500] ¹³

Shënim: këto dy kampione janë marrë para qytetit të Elbasanit më 21.09.2019

Çdo parameter fiziko-kimik i matur ka karakteristikat e veta që ndikojnë pozitivisht kur janë brenda normave, vlera të cilat janë të domosdoshme për jetën e gjallesave bimore dhe shtazore, si dhe mund të bëhen vdekjeprurëse për këto të fundit kur janë jashtë normave. Duhet të kemi parasysh se këto parametra mund të kenë ndryshime në lumenj të ndryshëm për shkak të temperaturave, lartësive, presionit, formacioneve gjeologjike ku kalojnë, etj. Shkumbini është një lumë që ka dy karakteristika atë malor dhe fushor pasi kalon qytetin e Elbasanit, por ndotja më e madhe i vjen nga ujrat e patrajuara që derdhen në trupin e lumit dhe mbetjet e ngurta.

1. Amoniak (NH₃+/NH₄+) Amoniak është një gaz pa ngjyrë dhe më një aromë të fortë të athët. Amoniak reagon me ujin duke formuar një bazë të dobët. Termi amoniak i referohet dy formave kimike të cilat janë në ekuilibër në ujë (NH₃, pa-jonizuar dhe NH₄⁺, i jonizuar). Analizat për amoniak zakonisht masin totalin e NH₃ plus NH₄⁺.

Toksiciteti i amoniakut i atribuohet formës së pajonizuar të NH₃ në krahasim me NH₄⁺ si sasi ose gjendje në ujë. Në përgjithësi më tepër prani të NH₃ dhe toksicitet më të lartë gjendet në pH të larta.

2. Nitrate (NO₃-) (mg/l) Azoti gjendet me bollëk në tokë, duke zënë 80% të ajrit në formën N₂ në gjendje të gaztë. Shumë bimë nuk mund ta përdorin në këtë formë. Algat jeshile-blu dhe perimet kanë aftësi të shëndrrojnë N₂ e gaztë në nitrate (NO₃-), të cilat mund të përdoren nga bimët. Bimët përdorin nitratet për të formuar proteinat dhe kafshët që hanë bimë gjithashtu përdorin azotin organik për të prodhuar proteina. Kur bimët ose kafshët vdesin ose kthehen në mbetje, ky azot çlirohet në mjedis në formën NH₄⁺ (amoniak), i cili oksidohet nga bakteriet dhe

¹³ Vlerat e konduktivitetit midis këtij intervali tregojnë për një mjedis lumor të favorshëm për pjesën më të madhe të botës së peshqve, burimi EPA.

kthehet në Nitrite (NO₂⁻). Dhe, kjo formë është më e zakonshme në ekosisteme me ujë të pastër.

Nitratet hyjnë në sistemin e ujrave që rrjedhin nëpërmjet burimeve natyrore të dekompozimit të bimëve, mbetjeve të kafshëve si dhe nga burime njerëzore me anë të ujërave të zeza ose nga plehu kimik/organik.

Nivelet natyrore të nitrateve janë zakonisht më pak se 1mg/l. Përqendrimet mbi 10mg/l kanë ndikime në mjedisin ujor. Për specie ujore, peshq të ndjeshëm, kjo vlerë rekomandohet shumë e ulët, p.sh. në rastin e salmonit është 0.06 mg/l.

Sasi të mëdha të azotit mund të rezultojnë në shtimin e fitoplanktoneve dhe makrofiteve. Gjithashtu, në nivele të larta në ujin e pijshëm, është toksik për fëmijët e vegjël.

3. Nitrite (NO₂⁻) Siç është shpjeguar dhe më lart nitritet janë një ndërmjetës në oksidimin e amoniakut në nitrate. Shumë derdhje si ujërat e zera janë të pasura në amoniak, të cilat shtojnë përqendrimin e nitrateve në ujërat e lumenjve/liqeneve/etj ku derdhen. Ndaj, nivele të larta të nitriteve në ujërat e lumenjve shkaktojnë ndotje. Kjo formë e azotit mund të përdoret edhe si burim ushqimi për bimët sepse prezenca e nitriteve ndihmon në shtimin e bimëve. Nitritet janë gjithashtu toksike për jetën ujore nëse janë në nivele të ulta. Në ujrat e pandotura, nivelet e nitriteve janë përgjithësisht të ulta (<0.01 mg/l N).

Uji me nivel të ulët të oksigjenit të tretur mund të ngadalësojë shkallën në të cilën amoniaku kthehet në nitrite (NO₂⁻) dhe në fund në nitrate (NO₃⁻). Nitritet dhe amoniaku janë më toksike se nitratet në ekosistemin ujor.

4. Lëndë organike, ose nevoja biologjike për oksigjen NBO₅ (mg/l O₂) Oksigjeni luan një rol të rëndësishëm në proceset e frymëmarrjes dhe në metabolizimin e organizmave të gjallë. Të vetmet qeliza të gjalla që nuk kanë nevojë për oksigjen janë disa baktere anaerobike që mbartin energji nga procese të tjera metabolike. Rrjedha e ujit prodhon dhe konsumon oksigjen. E merr atë nga atmosfera dhe nga bimët si rezultat i fotosintezës. Ujërat që rrjedhin tresin më shumë oksigjen se ato të ndenjura. Nëse konsumohet më shumë oksigjen sesa prodhohet, nivelet e oksigjenit të tretur do të ulen dhe disa specie të ndjeshme do të largohen, dobësohen ose vdesin. Ujërat e ftohtë kanë më shumë oksigjen se ujrat e ngrohtë, dhe uji përmban më pak oksigjen në lartësi të mëdha.


Kafshët ujore janë të prekura nga nivele të ulëta të oksigjenit herët në mëngjes gjatë ditëve të nxehta të verës kur rrjedha e ujit është në nivel të ulët, temperatura e ujit është e lartë dhe bimët ujore nuk prodhojnë oksigjen që nga perëndimi i diellit.

Vlerat e larta të nevojës për oksigjen janë shenjë e ndotjes organike. Ujrat e lumenjve të pastër kanë një vlerë NBO5 të matur përgjatë 5 ditëve dhe që rezulton më pak se 1 mg/L. Ujrat në nivel të moderuar të ndotjes kanë një interval vlerash të NBO5 midis 2 deri në 8 mg/L.

Në gusht të këtij vitit EUROSTAT publikoi raportin e Monitorimit të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm. Në këtë raport sipas objektivit nr.6. “Ujra të pastër dhe saniteti” janë pasqyruar edhe vlerat e NBO5 të matura në lumenjtë evropianë. Lumenjtë në Shqipëri rezultojnë me një nivel tepër të lartë të ndotjes duke qendruar në krye të këtij grafiku. Dhe kjo tregon që ndotja organike është e lartë si në grafikun më poshtë:

Source: EEA (Eurostat online data code: sdg_06_30)

Figure 6.5: Biochemical oxygen demand in rivers, by country, 2010 and 2015
(mg O₂ per litre)



14

Vlerat e faktura në këtë raport të publikuar më 2019 janë një krahasim matjesh midis vitit 2010 dhe 2015. Duke konsideruar që në këtë 4vjeçar nuk ka pasur përmirësime në infrastrukturën menaxhuese mjedisore, trajtim ujrash/mbetjet urbane, këto vlera qendrojnë edhe për rrethanat e tanishme.

5. pH pH është një parametër që tregon aciditetin në ujë. Në ujë, disa molekula (H₂O) do të zbërthehen në jone hidrogjeni (H⁺) dhe jone hidrokside (OH⁻). Përbërës të tjerë që hyjnë në ujë

¹⁴ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/9940483/KS-02-19-165-EN-N.pdf/1965d8f5-4532-49f9-98ca-5334b0652820>


mund të krijojnë reaksione me këto jone, duke sjellë një ç'ekuilibër të numrit të joneve të hidrogjenit dhe hidroksideve. Nëse më shumë jone hidrogjeni hynë në reaksion, më tepër jone hidrokside janë lënë në masën e ujit dhe uji quhet bazik; nëse më shumë jone hidrokside hyjnë në reaksion dhe jone hidrogjeni janë lënë në masën e ujit atëherë kemi me një mjedis acid. Pra, pH është një parametër që mat numrin e joneve të hidrogjenit dhe rrjedhimisht mat aciditetin. Organizmat e gjallë ujorë preferojnë një mjedis me pH midis 6.5 në 8.0.

6. Temperatura Temperatura e ujit ndikohet nga disa faktorë si temperatura e ajrit, nga stuhitë, rrjedhje të ujrave nëntokësore, turbullira dhe ekspozimi ndaj diellit. Për të konsideruar shëndetin e organizmave, është e nevojshme të konsiderojmë maksimumin dhe optimumin e temperaturës. Maksimumi i temperaturës është vlera më e lartë e temperaturës së ujit në të cilën organizmat mund të jetojnë për pak orë. Optimumi i temperaturës është vlera në të cilën ato do të lulëzojnë/mbijetojnë.

7. PO4-3 (fosfati mg/l) Sipas raportit të EUROSTAT niveli i fosfatit në ujrat shqiptare është në nivele shumë të larta:

Source: EEA (Eurostat online data code: sdg_06_53)

Figure 6.9: Phosphate in rivers, by country, 2010 and 2015
(mg PO₄ per litre)



Në terma ekologjike, për shkak të rolit të tij të rëndësishëm në sistemet biologjike, fosfati është një burim shumë i nevojshëm. Në përqendrime të larta fosfati mund të shkaktojë probleme në cilësinë e ujit, të tilla si eutrofikimi, duke nxitur rritjen e makrofiteve dhe algat. Shtimi i niveleve të larta të fosfatit në mjedise dhe mikro-ambiente në të cilat është zakonisht i rrallë mund të ketë pasoja të rëndësishme ekologjike. Për shembull, lulëzimet në popullatën e disa organizmave në


kurriz të të tjerave dhe kolapsi i popullatave të privuara nga burime të tilla si oksigjeni (shiko eutrofikimin) mund të ndodhin. Në kontekstin e ndotjes, fosfatet janë një përbërës i solideve të tretura totale, një tregues kryesor i cilësisë së ujit, por jo e gjithë fosfori është në një formë molekulare që algat mund ta prishin dhe konsumojnë.

8. Konduktiviteti ($\mu\text{S}/\text{cm}$). Konduktiviteti elektrik në ujë mat sasinë totale të lëndëve të ngurta të tretur në ujë (TDS-Total Dissolved Solids), TNT-Totali i lëndëve të ngurta të tretura në ujë. Konduktiviteti në ujë varet nga temperatura e ujit, sa më e lartë temperatura ashtu varion edhe niveli i konduktivitetit pasi kjo rrit mundësinë e tretjes së lëndëve të ngurta. Konduktiviteti rritet me 2-3% për çdo rritje prej 1 gradë Celsius të temperaturës së ujit. Ndërkohë që konduktiviteti është një tregues i mirë i kripësisë në ujë sërish nuk siguron të dhëna për përbërjen jonike të ujit. Vlerat e konduktivitetit midis intervalit (150, 500) $\mu\text{S}/\text{cm}$ tregojnë për një mjedis lumor të favorshëm për pjesën më të madhe të botës së peshqve

Njësitë matëse të konduktivitetit elektrik në ujë janë $\mu\text{S}/\text{cm}$ (microSiemens/cm) ose dS/m (deciSiemens/m):

Ku: $1000 \mu\text{S}/\text{cm} = 1 \text{ dS}/\text{m}$ (pajisja jonë mat konduktivitetin në $\mu\text{S}/\text{cm}$)

Edhe pse konduktiviteti matet me TDS duhet patur parasysh se kur përqendrimi i kripës arrin një nivel të caktuar, përçueshmëria elektrike nuk lidhet më drejtpërdrejt me përqendrimin e kripërave. Kjo për shkak se formohen palë jonike. Çiftet e joneve dobësojnë ngarkesën e njëri-tjetrit, kështu që mbi këtë nivel, TDS më i lartë nuk do të rezultojë në një përçueshmëri elektrike që rritet po në mënyrë lineare siç paraqitet në grafikun më poshtë:



¹⁵EC-tregon konduktivitetin elektrik

TDS- tregon totalin e lëndëve të ngurta të tretura në ujë

Në këtë grafik duket qartë që pasi vlera e TDS vazhdon të rritet EC qëndron konstante.

¹⁵ <https://www.smart-fertilizer.com/articles/electrical-conductivity>

4.0 Shëndeti i Mjedisit¹⁶

Në këtë kapitull do të përdorim termin Shëndeti i Mjedisit në vend të asaj që përdoret më shpesh mjedis i shëndetshëm pasi do të përqendrohemi se si lidhet shëndeti i mjedisit me atë të njeriut. Sot, duke u përballuar me situatën e ndotjes plastike në oqeanë ku llogaritet siç edhe e përmendëm në kapitujt e parë që 80% e mbjetjeve në oqeanë janë me burime tokësore po qarkullon gjithnjë e më shpesh shprehja: *Ç'ka hedh sot në lumë do ta shërbejë deti nesër në pjatë*. Në studimet e kryera është përllogaritur se në lumin Shkumbin depozitohen rreth 240-270 ton mbetje në vit, të gjitha këto me destinacion përfundimtar detin Adriatik. Kemi dhe parasysh që Bashkitë Prrenjas, Librazhd dhe Elbasan derdhen në rrjedhën e lumit të pa trajtura ujrave të zeza dhe ato urbane, kuptohet që edhe fshatrat përreth aty ku ka mungesë të gropave septike i derdhen ato direkt në trupat ujorë më të afërt.

Me këto fakte do të ndalemi me lidhjen e përgjithshme midis gjendjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut për vlerësimin real të barrës së sëmundjes në lidhje me shëndetin mjedisor. Pajtohemi me idenë se shëndeti i njeriut dhe cilësia e jetës varen nga ekologjia globale dhe lokale si dhe nga mënyra e menaxhimit të saj.

OBSH ka formuluar si më poshtë se çfarë kuptohet si shëndet i mjedisit, ky përkufizim është formuluar në vitin 1993 në një konsultim në Sofje, Bullgar:

“Shëndeti i mjedisit përmban ato aspekte të shëndetit të njeriut duke përfshirë cilësinë e jetës. Këto përcaktohen nga faktorët fizikë, kimikë, biologjikë, socialë dhe psikosocialë në mjedisin përreth. Gjithashtu, i referohet teorisë dhe praktikës së vlerësimit, korrigjimit, kontrollit dhe parandalimit të atyre faktorëve në mjedis që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.”

Në vitin 2006, OBSH publikoi një raport të titulluar ‘Parandalimi i sëmundjes përmes mjedisit të shëndetshëm’. Raporti adreson pyetjen kryesore: Sa shumë barrë të sëmundjeve mund të parandalohet nga ndërhyrjet mjedisore?

Duke marrë parasysh pjesën e mjedisit që mund të ndryshohet nga ndërhyrjet ekzistuese raporti vlerësoi se 24% e barrës së sëmundjes globale ishte e lidhur me faktorët e rrezikut mjedisor.

¹⁶ Referuar leksionit ‘Environmental Health’, kursi ‘Menaxhimi Global Mjedisor’, Technical University of Denmark (DTU)

Ky vlerësim krahasohet me vlerësimet e mëparshme. Në raportin e OBSH-së 2006, sëmundjet me një raport të madh që i atribuohen faktorëve mjedisorë të modifikueshëm përfshijnë sëmundje diarreale me një fraksion 94%, infeksione të poshtme të frymëmarrjes, malarje, lëndime të paqëllimita, etj., të gjitha me një raport të atribuar ndaj faktorëve mjedisorë të modifikueshëm me rreth 40%. Tek fëmijët, 34% e barrës së sëmundjes i atribuohet mjedisit, dhe një pjesë e madhe e kësaj barrë është vendosur në vendet me të ardhura të ulëta.

Disa nga rreziqet që shkaktojnë sëmundje janë: Ujë me cilësi të dobët, qasje të pamjaftueshme në burimet ujore, mungesë kanalizimesh të përshtatshme dhe higjienë personale të ulët. Faktorë të tillë rritin shumë sëmundjen tonë të vërtetë, infeksionet e krimbave të zorrëve, sëmundjet e lëkurës dhe syve dhe një numër problemesh të tjera të ujit dhe higjienës.

Sipas shifrave të vitit 2011 të përfshira në përditësimin e vitit 2013 nga programi i përbashkët i WHO UNICEF për monitorimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duket se bota nuk njihet ende mirë për të përmbushur qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit për furnizimin me ujë të 89% të popullsisë botërore që kanë aktualisht qasje në ujë të pijshëm të sigurt. Sidoqoftë, është e rëndësishme të pranojmë që bota ende pret rreth 770 milion njerëz, të cilët duhet të mbështeten te burimet e ujit të pijshëm. Ndotja e lumenjve është një kërcënim për arritjen e kësaj shifre dhe për sigurimin e plotë me ujë të pijshëm dhe të sigurt.

Me sistemet e kanlizimeve në tërësi bota është në rrugë të mbarë, por autoritetet nga nivelet lokale dhe ato rajonale duhet të zgjerojnë kornizën rregullatore dhe teknologjitë e tyre për të përmirësuar menaxhimin dhe ripërdorimin e mundshëm të ujërave të ndotura.

Përveç ndotjeve biologjike, lëndëve ushqyese në ujë dhe ujërat e ndotura në Planet e ardhshme të Menaxhimit do të duhet të marrin në konsideratë rritjen e kimikateve, metaleve të përfshira në ujë për shkak të rritjes së industrializimit.

Urbanizimi është një proces që po vazhdon me një ritëm të shpejtë, duke ndryshuar shoqëritë dhe peizazhin mjedisor në çdo kontinent. Urbanizimi është rezultat i migrimit të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane, plus natyrisht rritja demografike urbane. Modele të shpejta të paplanifikuara dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban po i bëjnë qytetet në zhvillim pika qendrore për shumë rreziqe mjedisore që po shfaqen.

Kjo përfshin depozitimin e mbeturinave të ngurta, menaxhimin e ujërave të ndotura, sigurimin e ujit të sigurt, kanalizimet, zhurmën, sigurinë e ushqimit, trafiku, parandalimi i dëmtimeve në punë dhe cilësia e ajrit.

Në të gjithë botën, banorët e lagjeve urbane ka të ngjarë të jenë më të rrezikuarit ndaj rrezikut mjedisor urban.

Një çështje tjetër e rëndësishme shëndetësore mjedisore është përkatësisht zhvillimi i burimeve ujore. Zhvillimi i burimeve ujore i referohet infrastrukturës dhe menaxhimit të kërkuar për kontrollin e ujërave të ëmbla, për të përmbushur kërkesat në bujqësi, entitet ose rezervuar për ujë të pijshëm. Infrastruktura përfshin skemat e ujitjes, rezervuaret e ujit dhe digat e mëdha, ndër burimet më të rëndësishme ujore.

Gjatë dhe pas krijimit të një infrastrukture të tillë, duhet të merren parasysh një varg aspektesh të mundshme pozitive dhe negative. Ndër përfitimet e mundshme, rritja e prodhimit dhe të ardhurave bujqësore dhe disponueshmërinë e një sasive të rritur të ujit për qëllime shtëpiake, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin e njeriut.

Sidoqoftë, për shumë vite zgjerimi i ujitjes është shoqëruar me një rritje të rritjes së mushkonjave ose kërmijve në kanalet e ujitjes, grykëderdhje të vogla të fushave ligatinë ose me mbajtje uji.

Mushkonja dhe kërmijtë e tillë mund të rrisin transmetimin e infeksioneve parazitare ose të viruseve, të tilla si malarja, encefaliti japonez, ose skistosomiasis, e quajtur edhe bilharzia (këto të vlerësuara në shkallë globale).

Është e domosdoshme të ketë njohuri për mjedisin lokal, dhe ndoshta vlerësime të ndikimit në shëndet, të nevojshme për të vlerësuar rrezikun e plotë të sëmundjeve të shkaktuara nga mushkonjat, ose sëmundje të tjera që lidhen me këto.

Le të shkojmë përtej menaxhimit të ujit për të adresuar aspektet më të gjera të burimeve natyrore. Tkurrja e mbulesës pyjore, sistemi i paqëndrueshëm i prodhimit, ndryshimi i klimës dhe menaxhimi i dobët i burimeve natyrore ndikojnë dukshëm në jetesën, sigurinë ushqimore, modelet e migracionit dhe natyrisht shëndetin e njeriut. Vlerësohet se rreth gjysma e tokës që përdoret aktualisht për prodhimin bujqësor është prekur në mënyrë të moderuar ose të rëndë nga degradimi i tokës që rezulton nga: humbja e tokës me cilësi për shkak të akumulimit të kripërave në sipërfaqen e tokës. Humbja aktuale e tokës së punueshme vlerësohet të jetë 30-35 herë më e lartë se niveli historik. Duke prekur 1.5 miliardë njerëz në planet dhe duke minuar të ardhmen për brezat që vijnë. Një shqetësim i veçantë është humbja e biodiversitetit. Njohja në rritje se diversiteti biologjik është një pasuri globale me vlerë të jashtëzakonshme për brezat e sotëm dhe të ardhshëm nuk ka sjellë ulje të zhdukjes së specieve të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, e cila vazhdon me një normë alarmante.

Duke iu përgjigjur nevojës për të mbrojtur pjellorinë e tokës dhe biodiversitetin, dy konventa kryesore janë zhvilluar si rezultat i Samitit të Tokës në Rio. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Shkretëtirës që solli vëmendje në degradimin e tokës në tokat e thata. Dhe Konventa për Diversitetin Biologjik kushtuar mbrojtjes së biodiversitetit global.

Në shumë zona të botës, sistemet e prodhimit bujqësor bëhen gjithnjë e më intensive, me përqëndrim të shtuar tek mono-kultura, të lashtat dhe varësia nga inputet siç janë pesticidet, plehrat dhe farat e përparuara. Kjo mund të ketë ndikime pozitive, por edhe negative në statusin ushqyes dhe nivelet e të ardhurave të familjeve bujqësore. Sidoqoftë, do të rezultojë në të njëjtën kohë në një nivel të rritur të ndotjes së tokës dhe ujit. Përdorimi i shtuar dhe disponueshmëria e pesticideve toksike dhe familjeve bujqësore do të rezultojë në rritjen e incidencës së helmimeve akute.

Gjithnjë e më shumë produktet bujqësore tregtohen nëpër vende dhe rajone të botës dhe krijojnë një burim jetësor të të ardhurave të huaja dhe janë një pjesë e rëndësishme e sigurisë globale të ushqimit. Sidoqoftë, një tregti e tillë në rritje gjithashtu vendos përgjegjësi të konsiderueshme në sektorin privat dhe qeveritar për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve global.

Të lashtat e ndotura nga ujërat e zeza, ushqimi me nivele të konsiderueshme pesticidesh ose produkte bujqësore që mbajnë patogjen nga një pjesë e botës në tjetrën, është një problem në rritje në një botë të globalizuar.

Qeveritë po punojnë për të përmirësuar sistemet e monitorimit dhe shkëmbimin e informacionit. Sektori privat synon të përmirësohet në sistemet e sigurimit të cilësisë, por sfidat janë të mëdha dhe konsumatorët gjithnjë e më shumë do të duhet të marrin në konsideratë dhe të përballojnë rreziqet e reja potencialisht. Më të rëndësishmet janë kapacitetet dhe sistemet stimuluese që promovojnë produkte të sigurta bujqësore dhe do të duhet të forcohen midis prodhuesve vendorë.

Siç duket qartë nga disa nga temat e shëndetit mjedisor të diskutuara në këtë pjesë, shumë sfida të ngutshme të shëndetit mjedisor nuk mund të adresohen vetëm në një nivel lokal ose kombëtar.

Një shembull i mëtejshëm i kësaj nevojë zbulon bashkëpunimin kombëtar dhe lëvizja ndërkufitare e ndotësve organikë të vazhdueshëm siç është DDT, adresuar në Konventën e Stokholmit. Një shembull tjetër më i fundit është miratimi ndërkombëtar i traktatit përfundimtar

juridik detyruet që synon të zvogëlojë emetimet e mërkurit. Mërkuri njihet si një nga kimikatat me shqetësim shëndetësor global, i ngjashëm me atë që është shprehur për ndotësit organikë.

Një shembull tjetër për të ilustruar nevojën për bashkëpunim në rritje është tregtia në rritje me produkte të ndryshme. Konventa e Bazelit e miratuar në vitin 1989 ka vendosur të kontrollojë lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe deponimin e tyre. Ky dhe modalitetet e tjera do të duhet të përditësohen dhe zgjerohen vazhdimisht për t'u marrë me kategoritë e reja të mbetjeve, tregjet në zhvillim që lidhen me to si për shembull, tregtinë me mbeturinat elektronike.

Në nivelin kombëtar dhe lokal, vendet kanë krijuar projekte, departamente dhe programe përkatës për të adresuar sfidat e shëndetit mjedisor.

Për fat të keq, shumë programe të tilla janë në mënyrë domethënëse të pa pasuruara me burimet e nevojshme. Ato të veprojnë në bazë të kornizave të dobëta të politikave, kanë vështirësi në koordinimin nëpër sektorë, dhe shpesh kanë kapacitete të kufizuara për të zbatuar standardet e përcaktuara. Dhe këto ndërhyrje apo veprime u delegohen strukturave që kanë përgjegjësi dhe duhet të veprojnë si për shembull, departamentet e shëndetit mjedisor, njësitë e shëndetit dhe sigurisë në punë, bashkitë, departamentet e bujqësisë dhe inspektorët veterinarë dhe të shëndetit publik etj, por për shkaqet si më lart këto ngelen të pa zbatuara si duhet.

5.0 Ligji dhe Kriminologjia Mjedisore

Menaxhimi i mbetjeve urbane rregullohet me ligjin Nr.10463, datë 22.09.2011 "Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve Urbane si dhe ligji Nr. 8094 datë 21.03.1996 "Për largimin e Mbetjeve Urbane". Baza plotësohet dhe me VKM-të dhe Udhëzimet përkatëse si dhe Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet Mjedisit".

Njësitet vendore kanë përgjegjësi në hartimin e "Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve" në bazë të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, sipas ligjit të "Mbrojtjes së Mjedisit". Njësitet Vendore mund të kryejnë trajtimin vetë të mbetjeve ose të kontraktojnë një tregtar, palë të tretë, që të kryejë këto operacione trajtimi sipas përshkrimeve të ligjit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, por gjithsesi Pushteti Vendor, Bashkia, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre.

Kreu XIV i Ligjit Nr.10463 mbi “Ndalimet, sanksionet dhe ndërshkimet” në nenin 61 dhe 62 paraqet rastet e kundravajteve sipas këtij ligji dhe masat penalizuese në gjoba. Pika 59, 60 dhe 61 e nenit 62 jep masat ndërshkimore për depozitimet informale, djegjet dhe shkarkimi dhe asgjësimi në formë të pakontrolluar për çdo person kundravajtës.

Lidhur me aktivitet kriminale mjedisore në rang botëror Interpol dhe UNEP në raportin *“Mjedisi, Paqja dhe Siguria si një konvergjencë kërcënimi”* kanë renditur krimin mjedisor si të katërtin aktivitet kriminal në shkallë botërore, dhe vlerësohet me një rritje prej 5-7% në vit. Vlera e llogaritur e këtij dëmi shtrihet në intervalin midis 91-259 bilion \$. Përgjigjet e vendeve të anketuara nuk kanë qenë në % të lartë dhe vlerësimi është bërë mbi bazën e raportimeve të marra. Si aktivitet kriminal është llogaritur gjuetia e paligjshme, trafikimi i specieve të rralla/në zhdukje, peshkimi i paligjshëm, shfrytëzimi i bimëve të rralla me veti të veçanta, i mineraleve të çmueshme, shpyllëzimi, etj.

Kriminologjia Mjedisore është një qasje e 2-3 dekadave të fundit dhe konsiderohet një shkencë e re në fushën mjedisore, dhe synon të identifikojë dhe masë aktivitetet e kryera në mjedis të cilat kanë pasoja afatgjata mjedisore. Sipas Brantingham (1991, p. 2), *“kriminologjia mjedisore argumenton se ngjarjet kriminale duhen marrë si bashkim i shkelësve, viktimave ose targetit kriminal dhe ligjeve në mjedise specifike, të gjitha këto brenda një kornizë të caktuar kohore dhe vendore”*. Kjo është arsyeja pse ‘kriminologët mjedisorë’ kërkojnë për forma të krimeve dhe përpiqen t’i shpjegojnë ato sipas ndikimeve mjedisore për kontekstin ku ato hasen. Nga këto vëzhgime prodhohen rregulla të cilat orientojnë në bërjen e parashikimeve të nevojshme, që mund të shfaqen nga problemet e krimit, dhe si rezultat të ndikojnë në zhvillimin e strategjive që duhen hartuar/zbatuar për të parandaluar krimet, zbutur dëmet dhe për një menaxhim efikas.

Legjislacioni shqiptar, për subjektin e trajtuar, parashikon këto masa, si më lart cekur, të cilat janë detyrë e Inspektoriatit Mjedisor të inspektojë në rast se ka shkelje, si dhe të penalizojë ligjshkelësit.

Në prezantimin e fazës së parë të projektit në Bashkinë Librazhd mbi gjetjet nga monitorimi, në terren, fillim nëntori 2018, përfaqësues nga Bashkia Librazhd, ISHP Librazhd, IM Elbasan, ADZM, etj shpjeguan se nuk aplikohen masa të tilla për depozitimet informale pasi siç është parë dhe gjatë monitorimit nuk ka një sistem të mirëfilltë menaxhimi të mbetjeve që operon në mënyrë të rregullt edhe për të gjithë fshatrat e Bashkisë së Elbasanit. Së pari, u dakordësuar që të kërkohet vendosja e një sistemi funksional dhe, ajo që mbetet për t’u diskutuar janë inspektimet mjedisore tek bizneset përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin. Diskutimi gjithashtu u

përqendrua në masën e vlerës së këtyre gjobave të cilat për një banor në zonë rurale, apo dhe biznes të vogël përgjatë lumit, kanë një vlerë shumë të madhe. Ligji parashikon gjoba nga 500'000 deri në 1'500'000 lekë. Por, Bashkia Elbasan mund të adaptojë rregulla të brendshme me masa më të arsyeshme vlerash, si shembull mund të shërbejë Bashkia Tiranë ku ka përcaktuar gjobat për hedhjen e mbeturinave jashtë koshave dhe të djegjes së tyre në vlerën nga 5 mijë në 10 mijë lekë.


Duhet vërejtur gjithashtu se vjelja e gjobave apo dëmshpërblimeve është një nga sfidat e tjera që përballen pushteti vendor. Por përpara kësaj për të siguruar një lumë të pastër nga mbetjet, për të pasur rezultate afatgjata, kërkohet një bashkëpunim dhe bashkërendim i ngushtë midis institucioneve përgjegjëse, shoqërisë civile dhe komunitetit.

6.0 Parimet e Menaxhimit të Mbetjeve

Vendet e BE-së rezultojnë me një qasje më të mirë ndaj menaxhimit të mbetjeve duke rivalizuar vendet e tjera, kjo qasje bazohet në zbatimin e disa parimeve të rëndësishme. Psh. një parim është "parimi i ndotësve paguan", që do të thotë se kompanitë prodhuese janë përgjegjëse për dëmet mjedisore. Ky parim ngarkon kompanitë dhe prodhuesit që të mbajnë përgjegjësi financiare dhe etike për ndotjen që shkaktojnë në mjedis duke mbuluar kostot e mbetjeve që ato prodhojnë. Më poshtë po sjellim parimin: Hierarkia e mbetjeve, Afërsia dhe vetëmjaftueshmëria, Ndotësi paguan dhe OMZM.

6.1 HIERARKIA E MBETJEVE

Zbatimi i hierarkisë për mbetjet reomandohet nga planet strategjike në përputhje me direktivat e BE-së. Hierarkia fillon me **Parandalimit, Përgatitjen për Ripërdorim, Riciklimin, Përpunimin për energji** dhe në fund **Groposja** në landfille si alternativa e fundit dhe më pak e rekomanduar, skematikisht si më poshtë.



Në praktikë vendosja e kësaj hierarkie kërkon një nivel të lartë organizimi dhe përfshin udhëzimet për ndarjen e mbetjeve në burim, kthimin e produktit dhe pranimin e standardeve të produktit të materialeve që rrjedhin nga mbetjet e ri-përpunuara.

Parandalimi: Parandalimi ndodh që në fazën e projektimit dhe prodhimit të produktit, por gjithashtu synon të inkurajojë konsumatorët që të mbajnë produkte për një kohë më të gjatë dhe t'i ri-përdorin ato. Kjo është një pikë thelbësore pasi përpiqet të minimizojë mbetjet para se të prodhohen duke përmirësuar projektimin e produktit dhe paketimin. Promovimi i parandalimit të mbetjeve duke përdorur objektiva ose mjete të tjera, taksa etj: p.sh., meqenëse ambalazhet produkteve shtëpiake përbëjnë një sasi të konsiderueshme të mbetjeve të përgjithshme shtëpiake dhe komunale mund të bëhen përmirësime në dizenjimin e tyre.

Ri-përdorimi: Kjo ka të bëjë me disa procese të ndryshme të kontrollit, pastrimit, riparimit, të artikujve ose pjesëve rezervë që kanë dalë jashtë përdorimit, dhe bëhen që ato të mund të ripërdoren sërish. Sipas vlerësimeve të fundit një e treta e të gjithë materialeve që vijnë në qendrat e riciklimit mund të ri-përdoren sërish. Për shembull, të paktën 25 % e mbeturinave elektronike kanë sërish vlerë të konsiderueshme të ri-përdorimit¹⁷. Pra, mund të bëhet shumë më tepër për të përfituar nga potenciali i ri-përdorimit.

Riciklimi: Ky proces tashmë i njohur për menaxhimin e mbeturinave përfshin kthimin e mbeturinave në një substancë ose produkt të ri. Riciklimi mund të përfshijë edhe kompostimin

¹⁷ <http://www.rreuse.org>

nëse plotëson protokollet e cilësisë. Sipas të dhënave e vërteta është se mbi 60 për qind e mbeturinave që përfundojnë në plehra mund të riciklohen¹⁸. Kështu ngrihet si detyrë e të dy palëve, prodhuesit dhe konsumatorit, që duhet të rrisin përpjekjet e tyre për riciklim.

Trajtimi: Trajtimi përfshin proceset e menaxhimit të mbetjeve siç janë tretja anaerobe, djegia për prodhimin e energjisë, gazifikim që prodhon energji (lëndë djegëse, ngrohje dhe energji) dhe materiale të tjera nga mbetjet. Kur riciklimi nuk është i mundur, llojet e tjera të trajtimit duhet të shqyrtohen në mënyrë që materiali të mos përfundojë në groposje/landfill.

Groposja: E fundit më pak e parapëlqyer është groposja ose djegia që nuk gjeneron energji.

6.2 AFËRSIA DHE VETËMJAFTUESHMËRIA

Parimet e afërsisë dhe të vetëmjaftueshmërisë kërkojnë që mbetjet të trajtohen sa më afër pikës ku ato prodhohen. Kjo vlen edhe për të shmangur kostot shtesë të transportit.

6.3 NDOTËSI PAGUAN

I interpretuar siç duhet ky nuk është vetëm një parim i shëndoshë që merret me ata të cilët ndotin mjedisin, por është një vazhdimësi e një prej parimeve më themelore të paanshmërisë dhe drejtësisë: *"njerëzit duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre"*. Ata që shkaktojnë dëme ose dëmtime për persona tjerë duhet të "paguajë" për këtë dëm, po kështu vlen dhe për mjedisin. Kjo thirrje për ndjenjën tonë të drejtësisë është arsyeja pse "ndotësi paguan" dhe vjen për të qenë në rezonancë me të dy aktorët kryesorë, politikbërësit dhe popullsinë.

Si rregull i përgjithshëm, analiza e shëndoshë ekonomike e ndotjes dhe e problemeve mjedisore duhet gjithashtu të bazohet në parimin e përgjegjësisë. Detyrimi i ndotësve për të përballuar kostot e aktiviteteve të tyre është një ekonomi e mirë gjithashtu, e cila jo vetëm që çon më tej paanshmërinë dhe drejtësinë, por edhe rrit efikasitetin ekonomik. Me fjalë të tjera, me politika të përshtatshme të bazuara në parimin ndotësi paguan, nuk duhet duhet

¹⁸ <http://www.conserve-energy-future.com/various-recycling-facts.php>

hequr dorë nga efikasiteti ekonomik i sistemit të tregut të lirë të bazuar në pronën private për të marrë në mbrojtje mjedisin, dhe jo anasjelltas¹⁹.

6.4 OPSIONI MË I MIRË I ZBATUESHËM MJEDISOR (OMZM)

Opsioni më i mirë i zbatueshëm mjedisor (OMZM) është opsioni i cili, gjithashtu merr së bashku parimet e sipërpërmendura. Strategjia Kombëtare propozon që zgjedhjet në menaxhimin e mbetjeve duhet të bëhen në përputhje me parimin e Opsionit më të Mirë të Zbatueshëm Mjedisor (OMZM). Parimi i OMZM ka mbështetur zhvillimin e Planeve Zonale të Mbetjeve të Shqipërisë dhe përcaktohet si: *“thekson mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit në tokë, ajër dhe ujë. Procedura e OMZM krijon për një grup objektivash mundësinë që siguron më shumë përfitime ose dëmin më të vogël për mjedisin, si një i tërë, për një kosto të pranueshme në terma afat-shkurtër ose afatgjatë”²⁰*.

Sipas PKMM ky objektivi është përdorur për t'i dhënë formë procedurës së OMZM të përdorur nga Grupet Zonale të Mbetjeve, për të cilat skuadra e projektit ka hartuar një udhëzim mbi vendimmarrjet e OMZM duke përcaktuar 20 kriteret vendimesh që duhen marrë nga grupet zonale të mbetjeve për të krahasuar dhe zgjedhur midis opsioneve të menaxhimit. Kriteret përfshijnë ndikimet mjedisore, përdorimin e burimeve, dhe kostot dhe përfitimet social-ekonomike.


7.0 ANALIZA E MENAXHIMIT MJEDISOR

Për të mbyllur këtë raport po bëjmë një analizë gjithëpërfshirëse të menaxhimit mjedisor për lumin Shkumbin bazuar në monitorimin tonë si dhe të dhënat historike, studime të mëparshme. Kjo analizë mund të shërbejë edhe për faza të tjera të këtij projekti apo për projekte të reja në të ardhmen me këtë temë. Për këtë po përdorim një nga mjetet që shërben për marrjen e vendimeve lidhur me çështje mjedisore ose për mbështetjen e tyre të hartuar nga EEA (Agjensia Evropiane e Mjedisit).

¹⁹ *A Proper Guide for Environmental Policy, Roy E. Cordato, Ph.D.*

²⁰ *Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve*

Korniza DIPSIR, e skematizuar si më poshtë, akronimi i të cilës qëndron për: Driving forces, Pressures, the State, Impacts, Responses, dhe në shqip: Forcat lëvizëse, Presionet, Gjendja dhe Përgjigjja (veprimi). Kjo kornizë shërben për të analizuar çdo faktor të jashtëm të sistemi që nis me Forcat Lëvizëse, ato që kanë potencial të sjellin ndryshime në mjedis, si dhe përshkallëzimi që ndodh në çdo hap deri në marrjen e veprimeve të duhura, Përgjigjja, dhe se çfarë është e nevojshme për ndërhyrje me qëllim parandalimin e vazhdueshëm nga dëmet.



Forcat lëvizëse (Drive)

- Mungesa e kontrollit periodik institucional;
- Marrja e inerteve (erozioni);
- Industritë, bizneset që zhvillohet përgjatë basenit të Lumit;
- Komuniteti dhe aktivitetet që kryen.

Presionet (pressure)

- Shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara & mbetjeve urbane;
- Erozioni, marrja e materialeve;
- Shkarkimet e mbetjeve industriale, kimikatet bujqësore;
- Depozitimi i mëparshëm i mbetjeve industriale.

Gjendja (state)

- Depozitime të mbetjeve urbane përgjatë rrjedhjes;
- Depozitime të mbetjeve industriale;
- Ndotje organike, kimike dhe metalesh;

- Erozion dhe përmytje.

Ndikimi (impakt)

- Humbje specimesh;
- Humbje tokash (erozioni);
- Prishjen e sistemeve vaditës, urave;
- Mungesë të barrierës natyrore në grykëderdhjen në det.

Përgjigjja/veprimi (response)

- Ndërgjegjësimi i komunitetit;
- Mirëfunksionimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve, shtimi numrit të koshave;
- Aksion pastrimi i depozitimeve informale;
- Nevoja për impiante trajtimi të ujrave të ndotur urbane dhe disiplinimi i atyre rurale;
- Rishikimi i licencave të subjekteve që marrin inerte;
- Rishikimi i licencave të HEC-eve;
- Monitorime të vazhdueshme mbi gjendjen mjedisore të lumit.

Ndërgjegjësimi i komunitetit që jeton përgjatë këtij pellgu është shumë i rëndësishëm dhe hap kyç për këtë projekt dhe për objektivat që parashtron. Kryesisht duhen përcjellë praktikatat e mira të ndarjes së mbetjeve dhe trajtimi veçmas i atyre organike. Në planin e veprimit duhen pasqyruar edhe disa ide se si të përdoren inertet, së pari të ndahen nga mbetjet e tjera dhe të largohen në mënyrë periodike nga vend-depozitimi që duhet të caktohet. P.sh. mund të përdoren për mbushje gropash në rrugët e fshatrave, Bashkia Elbasan duhet ta ketë parasysh këtë element për punën me menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu, këto depozitime informale duhen pastruar dhe më parë ose njëkohësisht të vendosen kosha mbeturinash sipas lagjeve apo kompozicionit të fshatit, duke konsideruar nr.e banorëve, largësitë nga rruga, etj. Dhe të sigurohet që sistemi i largimit të mbetjeve mirëfunksionon në mënyrë periodike.

8.0 Disa të dhëna nga Stafi i Bashkisë Elbasan

Në takimet e stafit të AlbNatyres dhe atij të Bashkisë Elbasan për të diskutuar mbi çështjen që trajton ky projekt u pa e nevojshme të paraqitej panorama aktuale e veprimtarisë që kryhet nga Bashkia me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe duke e krahasuar atë me monitorimin e kryer. Bashkia ka evidentuar një sërë të problematikës dhe në agjendën e saj mban prioritet punën e vazhdueshme të mbrotjes së mjedisit me parandalimin e ndotjes.

Së pari Menaxhimi i mbetjeve realizohet në dy forma në shërbimin e zonave rurale dhe asaj urbane. Për shërbimin në zonat rurale Bashkia na vuri në dispozicion të dhënat teknike si më poshtë, këto të dhëna përfshijnë gjithë Bashkinë Elbasan, përtej zonës së studimit:

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve deri më tani (2019) kryhet nga Bashkia dhe është i shtrirë në 8 NJA si: Papër, Bradashesh, Gjergjan, Shirgjan, Tregan, Gjinar, Labinot Fushë dhe Shushicë. Duhet theksuar se dhe në këto NJA_ve në disa fshatra malore të territorit të tyre ky shërbim mungon për mungesë të infrastrukturës rrugore të këtyre fshatrave dhe largesisë se tyre nga qendra, për pasojë dhe rritjen e koston të shërbimit por dhe duke u kthyer në ndotës potencial të ujrave sipërfaqesore në territoret e tyre;

- Volumi i mbetjeve i trajtuar në vit është afërsisht 3840/ton apo rreth 320 ton/muaji;
- Pa investimet (blerja e mjeteve, përmirësimi i infrastrukturës, etj) kosto e trajtimit në një vit shkon 23 milion lekeë e llogaritur në 5476 lekë/toni;
- Në disa fshatra të NJA Shushicë (Vreshtas, Hajdaran, Shelcan, Shushicë) shërbimi realizohet derë më duke patur kërkesën e gadishmërinë e familjareve, shërbim i cili gjatë aktivitetëve të ndërgjegjësimit kishte më shumë mbështetje nga pjesëmarrsit se sa shërbimi i përgjithshëm i realizuar në kontiniere të vendosur në çdo lagje apo grupim familjesh. Kjo u vërejt edhe në monitorimin e kryer, përveç fshatit Shelcan që paraqiti disa probleme mosfunksioni e dakordësimi midis palëve;

Drejtoria e menaxhimit të mbetjeve për zonen rurale e përkrahte këtë shërbim por evidentonte disa vështirësi si mungesa e experiences, mungesa e infrastrukturës rrugore, transportimi dhe orarin e vështirë të zbatimit nga familjarët, (disa familje koshat i kishin vendosur të fiksuar te porta dhe aty linin mbetjeve, ishin kosha të vegjël plastike ose të krijuar vetë);

- Frekuencat e pastrimit në të gjitha NJA_ve është 2 herë në javë, por në disa zona të populluara si psh NJA Tregan në stinën e verës dhe të vjeshtës për arsye të turistëve në ujrat termale (Ilixha) ky shërbim është i përditshëm;

- Shërbimi i menxhimit të mbetjeve nuk do shtrihet deri në fund të vitit 2019 në 4 NJA më të largëta siç janë Gracen, Funar, Labinot Mal dhe Zavalinë.

Së dyti të dhënat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për zonën urbane:

Volumi ditor i mbetjeve të menaxhuara 86 ton/dita x 365 dit = 31.390 ton/viti;

- Vlera e kontratës me kompaninë fituese 90 milion lek/viti;
Kosto 2.867 lekë/toni;
- Shërbimi derë më derë realizohet në 13 lagje të Bashkisë (në ato lagje ku nuk futen dot mjetet e rënda), por situata mjedisore në këto lagje është shumë herë më normale se në lagjet e tjera ku shërbehet me kontenier.

Bashkia Elbasan ka hartuar Planin e Menaxhimit të mbetjeve për një periudhë 4 vjeçare 2020-2024 gjë që tregon se interesin e madh që ka mbi reduktimin e ndotjeve dhe mbrojtjen e mjedisit dhe ku në fokus ka:

Shtrirja e shërbimit të trajtimit të mbetjeve në 4 NJA më të largëta siç janë Gracen, Funar, Labinot Mal dhe Zavalinë, ku ky shërbim deri më sot ka munguar si për mungesë të infrastrukturës rrugore të këtyre fshatrave por dhe vështirësive të tjera, fillimisht në fshatrat ku ekziston infrastruktura (në qendrat e tyre) dhe atje ku nuk ka mundësi për tu futur shërbimi të përdoret metoda e kompostimit duke diferencuar plastikën, qelqin dhe ambalazhet e tjera që nuk mund të kompostohen;

- Të nxitet ndërgjegjësimi për të realizuar shërbimin derë më derë (atje ku e lejojnë mundësitë) si metodë më efikase për uljen e ndotjeve e në veçanti në zonat ku nuk mund të hyjnë mjetet e rënda;

Përmirësimi i infrastrukturës që shërben më mirë për menaxhimin e mbetjeve;

- Të promovohen përvojat më të mira Europiane për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve në burim.

Së treti shërbimi i Ujësjiellës Kanalizimeve:

Aktualisht po kryhet një studim mbi ndëtimin e një impjanti të menaxhimit të ujrave të zeza, plan i cili përfshin zonën e projektit dhe Bashkinë Elbasan;

- Ky studim mbështetet në Planin e Qeverisë Shqiptare në kuadër të Programit “NJË OKB”;

Parashikohet të mbështetet nga Banka Gjermane për Zhvillim.

Gjithashtu, me mbeshtetjen e BB po realizohet studimi i mundësive të trajtimit të ujrave të lumit Shkumbin ku derdhen pothuajse të gjitha ujrat ndotëse të bardha dhe të zeza të bashkive të vendosura përgjatë brigjeve të tij, edhe kjo është ne kuadër të Programit të Qeverisë Shqiptare në zbatim të 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në këtë diskutim përfaqësuesit e Bashkisë konfirmuan që Bashkia Elbasan e ka vlersuar dhe ka në fokus për të ardhmen mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mjedisit ku dhe mbrojtja e ujrave ka pjesën e vet të rëndësishme.

Monitorimi në Njesinë Administrative Shushicë dhe Labinot Fushë




Tabela e koordinatave

X	Y
510695.1848	4557481.172
513211.2889	4557053.93
513203.6435	4556897.805
511234.2198	4558341.023
512621.4084	4556214.375
512614.6995	4556238.311
513739.8103	4557423.005
516558.3565	4559200.228
516608.3735	4559118.198
518709.3138	4558173.412
513609.5342	4557196.55
513868.331	4557042.421
508123.2415	4553953.092
507990.2605	4554063.869
507630.2806	4554637.887
508402.3937	4557245.214
507043.9984	4556109.556
506954.3957	4556295.267
506884	4551376
509448	4548646
509129.5	4548735
511758.7	4548474.6
510144.5	4551737.3
512181.5	4552318.3
513300.7	4553342
515460.3	4552828.9
515667.6	4552820.5
515768.3	4552779.9
516269.5	4554141.6
516259.7	4554129.1



Shoqata AlbNatyra realizoi këtë fazë të projektit në dy njësi administrative të Bashkisë së Elbasanit, Shushicë dhe Labinot Fushë, në sajë të një fondi të përbashkët të UNDP-së dhe Bashkisë Elbasan. Për portofolion e Shoqatës ky projekt është vazhdimësi i projektit të parë të realizuar në kornizën e të njëjtit program, ReLOaD, ku për fazën e parë ishte në studim segmenti i lumit Shkumbin brenda Bashkisë Librazhd.

Shoqata AlbNatyra është themeluar në vitin 2008 me Vendimin e Gjykatës nr. 2358 me emrin “Shoqata Rajonale e Pyjeve dhe Kullotave, Qarku Elbasan”, në vitin 2016 është ndryshuar emrin në “Shoqata AlbNatyra” me vendimin nr.2358/1.

Nga viti 2008 deri më 2016 Shoqata ka patur si mision kryesor menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore kryesisht me menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale, me rritjen e kapaciteteve të shoqatave lokale të pyjeve dhe kullotave, mbështetjen me trajnime, mbështetjen me këshillime si dhe përfaqësimin e tyre duke lobuar për çështjet e pyjeve dhe kullotave në nivelet më të larta të vendimmarrjes të shtetit Shqiptar. Përdorimi tradicional i pyjeve dhe kullotave siguron vazhdimësinë dhe menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore lokale. Në vitet e fundit AlbNatyra ka zgjeruar misionin e saj duke zhvilluar projekte të rëndësishme në zonën e veprimit, Qarku i Elbasanit, që mbulojnë çështje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e qendrueshëm mjedisor dhe të turizmit.

Kontakt:

Godina nr.40, Nj. A. Papër, Elbasan

Eml: racfp.org@gmail.com

Cel: +355 69 6223 130

www.albnatura.org & www.albnatura.blogspot.com

SHËNIM:

Ky material është hartuar në kuadër të projektit ‘Ujra të Mbrojtura për Komunitete të Shëndetshme’. Shoqata AlbNatyra vendos këto të dhëna në dispozicion të UNDP dhe Bashkisë Elbasan si financuese të projektit. Palë të tjera luten të kontaktojnë Koordinatorin e Projektit, ndalohej riprodhimi dhe përdorimi i këtij materiali pa marrjen e konfirmimit nga AlbNatyra.

©Shoqata AlbNatyra